



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-lzazna

Nr. -11-1469 Data 20.10.2023
Br. REPUBLIKA E KOSOVËS Datum

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC



ZYRA E KRYETARIT

RAPORT

(Diskutimi publik me “Kryetarët e Këshillave Lokal”)

Kryetari i Komunës së Obiliqit, z.Xhafer Gashi, së Bashku me Kryesuesen e Kuvendit Komunal, znj.Vlora Mjekiqi Kabashi, me datë 22.09.2023 ka mbajtur diskutimin publik me Kryetarët e Këshillave Lokal, diskutimi është mbajtur në Sallen e Kuvendit Komunal nga ora 14:00.

Gjatë diskutimit ishin prezent Kryesuesja e Kuvendit Komunal znj.Vlora Mjekiqi Kabashi, Shefi i Kabinetiit z.Burim Gërguri, pjesëtarë të ekzekutivit komunal, grupi punues për konsultime publik, Kryetarët e Këshillave Lokal dhe përfaqësues të OJQ-ve.

Të pranishëm në këtë diskutim kanë qenë gjithsej 10 qytetarë, prej tyre 5 femra dhe 5 meshkuj.

Takimin e hapi znj.Vlora Mjekiqi Kabashi, Kryesues e Kuvendit Komunal, e cila falënderio të pranishmit në sallë dhe fjalë ja kalon z.Burim Gërguri, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Obiliqit.

Z. Burim Gërguri, Shefi i kabinetit e hap debatin duke iu uruar mirëseardhje të pranishmëve dhe duke i njoftuar me temën e debatit. I prezanton kryetarët e këshillave lokal me stafin mbështetës në këtë debat, ky është takim i parë bazuar në rregulloren për bashkëpunimin me kryetarët e këshillave lokal, ku do të organizohen 2 takime përmes Kryesuese së Kuvendit Komunal, Kryetarit të komunës dhe kryetarëve të këshillave lokal. Në këtë takim të pranishmit u informuan për të gjitha aktivitetet në mënyrë të përgjithshme, dhe pas prezantimit të Buxhëtitit për vitin 2024 dhe planifikimet për viteit 2025-2026, kemi pranuar kërkesa për informacion nga Kryetarët e Këshillave Lokal.

- **Ramadan Cunaku, kryetar i këshillit lokal qendra 1:** këtu sot u bisedu edhe për punën e kryetarëve të këshillave lokalë, un kam një pyetje për ju, ju e përmendet digjitalizimin e shkollave për vitin 2025, duke e pas parasysh kohën në të cilën po jetojm ndoshta është më mire të fillohet me digjitalizim sa më shpejt. E përmende edhe një projekt tek shkolla “Dr. Ibrahim Rugova” unë mendoj që aty ka nevojë të ndërtohet edhe një shkollë në mënyrë që ti ikim ndrrimit të dytë.Po ashtu un dje kisha një takim me

qytetarë në shkollën “Dr. Ibrahim Rugova” numri i pjesëmarrësve ish dyfish më i madh se sa në takimin e parë, dhe gradualishtë ata po e kuptojnë që dikun është një kryetar i zgjedhur ku ata mund ti adresojnë të gjitha brengat e tyre dhe un kam pranuar disa kërkesa nga ata, un e kam një vrejte tek projekti i koogjenerimit, në pjesen ku po punohet po mbyllen gropat, mirpo a ka mundësi në pjesën ku bëhet mbyllja e gropave me asfalt të bëhet asfaltimi në mënyrë të drejtë, për këtë çështje kam pranuar vrejte nga ana e qytetarëve, kam edhe një pyjte tjertër, në kodër të Obiliqit janë disa familje që kanë shnumë problemem me ujë gjatë verës, është një gyp aty, tash mbasi po hapen këto kanale dikun rreth 50 metra është një kanal që duhet të lidhet në gypin kryesor që ata të mos kenë probleme.

Përgjigje

Burim Gërguri, Shef I Kabinetit, sa i përket kërkesës së fundit, do të bisedojë me drejtorinë e Shërbimeve Publike, që të sanohet ky problem, tek koogjenerimi ki të drejt mirpo kyqja e lagjeve do të ndodh vitin që vjen, po presim, prej gypit kryesor ku ka mbet do të bëhen kyqjet individuale, jemi komuna e pare në nivel vendi që e bëjmë kyqjen individuale, asfalti do të prehet prap edhe kemi mendu me nda një fond për pas përfundimit të punimeve të bëhet edhe asfaltimi i të gjitha rrugëve të dëmtuara, që do të paisen me shenjëzim dhe sinjalistikë, në mënyrë që për një kohë të gjatë mos kemi problem me rrugët.

Përgjigje

Vlora Mjekiqi Kabashi, Kryesuese e Kuvendit Komunal, nëse më lejoni do të isha përgjig tek pytja që u bë për hapsirën e shkollës “Dr. Ibrahim Rugova” un jam mësimdhënëse në atë shkollë, edhe dashtë Zoti me pas fëmij nxënës që me u zgjëru objekti, pasi që këtë vit numri i nxënësve është shnumë më i ulët, dhe kemi frik që nga janari e tutje do të ketë edhe më shumë ramje të numrit të nxënësve.

- **Mehdi Sopa, Kryetarti I Këshillit lokal - Milloshevë**, nuk e di sa jeni të njoftuar për dy gjëra që na janë premtu, na është premtu një çerdhe dhe rregullimi i stadionit i cili është në gjendje shumë të rëndë.

Përgjigje

Burim Gërguri, shef i kabinetit, sa i përket çerdhes, komuna e Obiliqit e ka nda lokacionin, çerdhen e ndërton Ministria e Arsimit, dhe po presim shumë shpejtë ta bëjmë edhe vendosjen e gurthemelit, tek stadioni është mendu, aty realishtë janë dy fusha sportive, njëra në Milloshev ku është ish ambollanta e vjetër që ja kemi dhan klubit të qytetit dhe tjertra tek pjesa e Raskovës pasi që edhe ajo është me Miloshevë, dhe është mendu që në to të investohet viteve të ardhshme, pasi që këtë vit kemi investu në fushën sportive tek stadioni i KEK-ut në Obiliq.

- **Fuad Hashani, kryetar I këshillit lokal Obiliq i Vjetër**, un e kom bo një kërkesë lidhur me një objekt që është dediku për çerdhe para 7-8 viteve nëse nuk jam gabim, un kam kërku që ky objekt të rrënohet ose të renovohet dhe të përdoret për nevoja të komunitetit për aktivitete të ndryshme.

Përgjigje

Burim Gërguri ,shëf i kabinetit, nëse nuk jam gabim në vitin 2014, një organizat në emër të UNICEF-it të cilët kanë pas një partneritet, dhe ne i kemi nda 10 ari trull në mënyrë që të ndërtohet një çerdhe në komunitet, ku me aq sa mbaj në mend në bazë të marrëveshjes 5 vitet e para organizata investon dhe pas 5 viteve i bartet objekti komunës, edhe ne e kemi pas vullnetin të ndërtohet një objekt i tillë për komunitet pasi që edhe kishim nevojë, mirpo Organizat e cila ka investu ka pas probleme dhe nuk i ka perfundu obligimet ndaj kompanis e cila ka qenë duke i kryer punimet, ne jemi duke i pritur afatet ligjore, dhe un mendoj që aj objekt duhet të rrënohet pasi që nuk e dim sa ka stabilitet, mirpo do ta trajtojmë këtë tem dhe do të shohim si do të veprojm më tutje.

Vlora Mjekiqi Kabashi, Kryesuese e Kuvendit Komunal, falënderoi të pranishmit në sallë për pjesëmarrjen për pytyet dhe kërkesat, dhe kërkoi nga kryetarët e këshillave lokal të marrin pjesë në seancat e kuvendit komunal, sepse aty përveq rendit të ditës tek pjesa të ndryshme diskutohet shumë çështje sa i përket problematikave që juve ju atakojnë drejt për së drejti në punën tuaj

Komente të tjera nuk kemi pranuar as në formën me shkrim, diskutimi publik ka përfunduar në ora 15:40.

Pjesë përbërëse e këtij raporti janë:

1. Procesverbali dhe
2. Lista e Pjesëmarrësve.

Obiliq
19.10.2023

Zyrtare përgjegjës për konsultime publike-Festina Preniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



ZYRA E KRYETARIT

PROCESVERBAL

Procesverbal i mbajtur me datën 22.09.2023 për diskutimin publik me “Kryetarët e Këshillave Lokal”

Të pranishëm në këtë takim: Kryesuesja e Kuvendit Komunal, Shefi i kabinetit, kryetarët e këshillave lokal, grupi punues për konsultime publike, drejtorë të drejtorive të ndryshme dhe përfaqësues të OJQ-ve.

Debati publik filloi në orën 14:00.

Takimin e hapi znj. Vlora Mjekiqi Kabashi, Kryesuesja e Kuvendit Komunal, e cila falënderio të pranishmit në sallë dhe fjalë ja kalon z. Burim Gërguri, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Obiliqit.

Z. Burim Gërguri, Shefi i kabinetit e hap debatin duke iu uruar mirëseardhje të pranishmëve dhe duke i njoftuar me temën e debatit. I prezanton kryetarët e këshillave lokal me stafin mbështetës në këtë debat, ky është takim i parë bazuar në rregulloren për bashkëpunimin me kryetarët e këshillave lokal, ku do të organizohen 2 takime përmes kryesueses së kuvendit komunal, kryetarit të komunës dhe kryetarëve të këshillave lokal, në emër të kryetarit Xhafer Gashi, kërkoj falje për mos prezencën e tij në këtë takim. Në këtë takim do të informoheni për të gjitha aktivitetet në mënyrë të përgjithshme, ne kemi mbajtur takime edhe për KAB-in dhe për buxhet 2024, 2025 dhe 2026, un do të prezantoj para jush buxhetin për vitin 2024 në pika të shkurta.

Këtë vit janë aktivizuar edhe këshillat lokal të cilët po e japin një kontribut të madh në komunën tone, komuna e Obiliqit ka gjithsej 12 këshilla lokal, me të cilë kemi një bashkëpunim të mrekullueshë.

Shefi i Kabinetit, z. Burim Gërguri, paraqet planifikimin e buxhetit për vitin 2024 si më poshtë:

1. Paga mëditje - 5,420,536 euro
2. Shërbime dhe mallra - 1,700,000 euro
3. Shpenzime komunale – 300,000 euro
4. Subvencione dhe transfere – 1,100,000 euro

5. Investime kapitale – 5,727,389 euro.

Sipas qarkores buxhetore të pranuar nga Ministria grantet janë si më poshtë:

1. Granti i përgjithshëm 3,438,437 euro
2. Granti specifik i arsimit 3,171,199 euro
3. Granti specifik i shëndetësisë 1,383,508 euro

Totali i granteve – 7,993,144 euro

- Ligji për Obiliqin - 5 milion euro

Totali i granteve dhe Ligjit për Obiliqin: 12,993, 144 euro

- Të hyra vetanake të parashikuara – 1,255,245 euro

Subvencionet

- Zyra e Kryetarit 20,000 euro
- Kultura - 130,000 euro
- Bujqësia - 227,000 euro
- Shëndetësia - 180,000 euro
- QPS - 3,000 euro
- Arsimi - 270,000 euro
- DSHPE - 170,000 euro
- DEFZH 100,000 euro

Totali të hyra 1,200,000 euro

Totali i buxhetit: 14,248,389 euro.

Për vitin 2025-2026 parashihet për herë të parë ndërtimi i shtëpive për komunitetin për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2025- 250.000 euro dhe në vitin 2026 - 200.000 euro.

Burim Gërguri: Komuna e Obiliqit kryen shërbime të mëdha për qytetarët, ku nga subvencionet përfitojnë shumë qytetarë. Buxheti i shpenzuar deri më tani është 77.60 %, shpenzimi për investime kapitale është 85%, të hyrat vetanake 73.68%, d.m.th. është bërë një punë e jashtëzakonshme. Gjithashtu për performancë komunale kemi ngritje, po e synojmë vendin e dytë, po ashtu deshta të ju informoj që në mbledhjen e fundit të asambles komunale, mbledhje e jashtëzakonshme, ka qenë rekomandimi i mbledhjes së muajit shkurt, për faljen e tatimit në prone në vlerë 100 euro, ku Kryesuesja e Kuvendit Komunal bashkë me antarët e kuvendit komunal, i kanë rekomandu qeverisë që të bëhet plotëcimi me infrastrukturë ligjore, për faljen e tatimit në prone n vlerë 100euro, në mbledhjen e jashtëzakonshme ka marrë vendim kuvendi komunal i Obilqit për faljen e tatimit në prone ku jemi ndër komunat e para, mirpo ky ligj ka

shku në Gjykatën Kushtetuese, është në pritje, është pezullu për momentin, dhe të gjithë ata që kanë paguar tatimin do të ribursohen në vitin 2024.

Sa i përket projekteve kapitale, projekti i koogjenerimit është projekti më i madhë gjegjësisht shtrirja e rrjetit të ngrohjes qendrore, pra pjesën më të madhe të investimeve kapitale do ta marrë ky projekt. Për fat të keq deri në këtë fazë, nuk kemi pas ndonjë mbështetje nga ministritë e linjës gjegjësisht nga ministria për ekonomi dhe financa dhe investimi në këtë projekt është paraparë me forca vetanake gjegjësisht nga të hyrat e komunës së Obiliqit dhe nga Ligji për Obiliq, po shpresojmë që viteve të ardhshme kemi me pranë donacion nga zyra e Bashkimit Europian, të cilët kanë filluar një fazë të projektit dhe janë në fazën e termave të referencës që do të thotë ne kemi hec një 4 hapa para, aty është një fazë mirpo ata janë duke menduar që duhet modaliteti për mu ngrohje qyteti i Obiliqit, Fushë Kosovës, Lipjanit, Drenasit dhe Podujevës. Në tash jemi në fazën e 4 të projektit, faza e parë ka qënë, ndërtimi i objektit, shtrirja e rrjetit primar që përfshin territorin e zonës së parë të Obiliqit, zona e dytë janë Mazgërat, zona e tretë janë Millosheva me Raskov dhe Bakshi dhe në fazën e katërt përfshihet Plemetini me Dardhishtë, dhe do të vazhdohet me faza të tjera.

Investimet kapitale të cilat janë parapa janë, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, është një projekt i veçantë, digjitalizimi i arkivës komunale, po ashtu para 2 javë është lansuar edhe aplikacioni Obilqi online, ku mund të regjistroheni me user, dhe të pranoni shërbime përmes këtij aplikacioni, në çdo ditë e më shumë jemi duke shkuar drejt digjitalizimit ku jemi duke u munduar që të jemi 24 h në shërbim të qytetarëve.

Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ndriqimi publik në rrugën "Mbretresha Teutë" Obilqi "Kushtrimi i Uçk-së" Kozaricë, "Selim Pllana" Lajthishtë, "Islam Mjeku" Graboc, "Hoxhë Breznica" me segmente, ndërtimi i shtëpisë për komunitete dhe persona me aftësi të kufizuara, ndërtimi i parkingut tek rruga "Adem Jashari" në Obilqi, ndërtimi i shtegut të biçikletave dhe trotuari në rrugën "Hasan Prishtina" Obilqi, ku do të vazhdojmë me projekte të gjelbërta dhe në shërbim të komunitetit, ndërtimi i urës automobilistike në Graboc, ndërtimi i parkut në Mazgërat të epërm, ky projekt është propozuar dhe votuar nga qytetarët në kuadër të buxhetimit me pjesëmarrje projekt ku jemi partnerë me USAID-in në Kontratën Sociale, ndërtimi i parkut rruga "Adem Jashari" Obilqi.

Drejtorja e Infrastrukturës, ndërtimi i kanalizimit në fshatin Lajthishtë, asfaltimi i rrugës "Kamber Beka" Breznica, asfaltimi i rrugës "Migjeni" Raskovë, rruga "Vatra" Mazgërat, asfaltimi i rrugës "Dukati" dhe rrugë të tjera, Instalimi i ngrohjes qendrore në qytetin e Obiliqit.

Drejtorja e Ambientit, rregullimi i parkut në Lajthishtë dhe lagjja Haziri në Mazgërat për vitin 2025.

Drejtorja e Arsimit, digjitalizimi i shkollave në Arsim, blerja e autobusëve për të cilët kemi mjaftë nevojë, dhe të cilët do të shfrytëzohen për nevojat e komunës, mirpo vikendeve mund të shfrytëzohen OJQ-të, apo edhe ju si kryetarë të këshillave lokal për ndonjë aktivitet që parashihni ta realizoni në fshatrat e juaj kjo pak a shumë është një përmbledhje e projekteve, po do të ketë edhe projekte të tjera që do të realizohen me ministri apo organizata të ndryshme, dhe fjalën ja kalon Kryesuesit të Kuvendit komunal e cila kërkon një raport për punën e kryetarëve të këshillave lokal, dhe fjalën e kalon tek të pranishmit.

Ramadan Cunaku, kryetar i këshillit lokal qendra 1: këtu sot u bisedu edhe për punën e kryetarëve të këshillave lokalë, un kam një pyetje për ju, ju e përmendet digjitalizimin e shkollave për vitin 2025, duke e pas parasysh kohën në të cilën po jetojm ndoshta është më mire të fillohet me digjitalizim sa më shpejt. E përmende edhe një projekt tek shkolla “Dr. Ibrahim Rugova” unë mendoj që aty ka nevojë të ndërtohet edhe një shkollë në mënyrë që ti ikim ndrrimit të dytë. Po ashtu un dje kisha një takim me qytetarë në shkollën “Dr. Ibrahim Rugova” numri i pjesëmarrësve ish dyfish më i madh se sa në takimin e parë, dhe gradualishtë ata po e kuptojnë që dikun është një kryetar i zgjedhur ku ata mund ti adresojnë të gjitha brengat e tyre dhe un kam pranuar disa kërkesa nga ata, un e kam një vrejtje tek projekti i koogjenerimit, në pjesen ku po punohet po mbyllen gropat, mirpo a ka mundësi në pjesën ku bëhet mbyllja e gropave me asfalt të bëhet asfaltimi në mënyrë të drejtë, për këtë çështje kam pranuar vrejtje nga ana e qytetarëve, kam edhe një pyjte tjetër, në kodër të Obiliqit janë disa familje që kanë shnumë problemem me ujë gjatë verës, është një gyp aty, tash mbasi po hapen këto kanale dikun rreth 50 metra është një kanal që duhet të lidhet në gypin kryesor që ata të mos kenë probleme.

Burim Gërguri, sa i përket kërkesës së fundit, do të bisedojë me drejtorinë e Shërbimeve Publike, që të sanohet ky problem, tek koogjenerimi ki të drejt mirpo kyqja e lagjeve do të ndodh vitin që vjen, po presim, prej gypit kryesor ku ka mbet do të bëhen kyqjet individuale, jemi komuna e pare në nivel vendi që e bëjmë kyqjen individuale, asfalti do të prehet prap edhe kemi mendu me nda një fond për pas përfundimit të punimeve të bëhet edhe asfaltimi i të gjitha rrugëve të dëmtuara, që do të paisen me shenjzëzim dhe sinjalistikë, në mënyrë që për një kohë të gjatë mos kemi problem me rrugët.

Vlora Mjekiqi Kabashi, nëse më lejoni do të isha përgjigj tek pytja që u bë për hapsirën e shkollës “Dr. Ibrahim Rugova” un jam mësimdhënëse në atë shkollë, edhe dashtë Zoti me pas fëmij nxënës që me u zgjëru objekti, pasi që këtë vit numri i nxënësve është shnumë më i ulët, dhe kemi frik që nga janari e tutje do të ketë edhe më shumë ramje të numrit të nxënësve.

Kryetarti I MILLOSHEVËS, nuk e di sa jeni të njoftuar për dy gjëra që na janë premtu, na është premtu një çerdhe dhe rregullimi i stadionit i cili është në gjendje shumë të rëndë.

Burim Gërguri, sa i përket çerdhes, komuna e Obiliqit e ka nda lokacionin çerdhen e ndërton Ministria e Arsimit, dhe po presim shumë shpejtë ta bëjmë edhe vendosjen e gurthemelit, tek stadioni është mendu, aty realishtë janë dy fusha sportive, njëra në Milloshev ku është ish ambollanta e vjetër që ja kemi dhan klubit të qytetit dhe tjertra tek pjesa e Raskovës pasi që edhe ajo është me Miloshevë, dhe është mendu që në to të investohet viteve të ardhshme, pasi që këtë vit kemi investu në fushën sportive tek stadioni i KEK-ut në Obiliq.

Fuad Hashani, kryetar I këshillit lokal Obiliq i Vjetës, un e kom bo një kërkesë lidhur me një objekt që është dediku për çerdhe para 7-8 viteve nëse nuk jam gabim, un kam kërku që ky objekt të rrenohet ose të renovohet dhe të përdoret për nevoja të komunitetit për aktivitete të ndryshme.

Burim Gërguri, nëse nuk jam gabim në vitin 2014, një organizat në emër ë UNICEF-it të cilët kan pas një partneritet, dhe ne i kemi nda 10 ari trull në mënyrë që të ndërtohet një çerdhe në komunitet, ku me aq sa mbaj në mend në bazë të marrëveshjes 5 vitet e para organizata investon dhe pas 5 viteve i bartet objekti komunës, edhe ne e kemi pas vullnetin të ndërtohet një objekt i tillë për komunitet pasi që edhe kishim nevojë, mirpo Organizat e cila ka investu ka pas probleme dhe nuk i ka perfundu obligimet ndaj kompanis e cila ka qenë duke i kryer punimet, ne jemi duke i pritur afatet ligjore, dhe un mendoj që aj objekt duhet të rrënohet pasi që nuk e dim sa ka stabilitet, mirpo do ta trajtojmë këtë tem dhe do të shohim si do të veprojm më tutje.

Vlora Mjekiqi Kabashi, falënderoi të pranishmit në sallë për pjesëmarrjen për pytjet dhe kërkesat, dhe kërkoi nga kryetarët e këshillave lokal të marrin pjesë në seancat e kuvendit komunal, sepse aty përveq rendit të ditës tek pjesa të ndryshme diskutohet shumë çështje sa i përket problematikave që juve ju atakojnë drejt për së drejti në punën tuaj.

Takimi mbaroi në orën 15:00 dhe të pranishëm ishin 10 pjesëmarrës.

Procesmbajtëse: Festina Preniqi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIĆ



Lista e pjesëmarrësve: KRYETARI I KOMUNËS – TAKIM ME KRYETARËT E KËSHILLAVE LOKAL.

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Filloi në ora: 14:00

Data: 22.09.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Telefoni	E-mail	Nënshkrimi
1.	MËHDI SORI	MILLOSHEV	045 104-153		
2.	FUAD HASHANI	OBILIĆ I VJETER	044/912020	fuad.hashani@hotmail.com	
3.	VAHUDIN IBRAHIM	OBILIĆ P. QONG	044/590-446		
4.	Vlora Huhimi	Obilić	044/813 1841		
5.	Ramadan Gumbek	Qendrore 1"	044/642-512	rgunakov@hotmail.com	
6.	Valentina Aliu	Miloshore	025-677-583	valentina.96@gmail.com	
7.	Venditor Bajxhi	BATNICE	046 200204		
8.	Vlora H. Rabesha	Obilić	—	vlora.h.kabesha@kq.gov.net	
9.	Blerim Gësheqer	Kryesori i T	045-165-500		
10.	Festina Pranizi	Obilić	045 642-310		
11.					
12.					
13.					
14.					
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Telefoni	E-mail	Nënshkrimi